

VENDIM
Nr.363, datë 6.6.2007

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” PËR HIDROCENTRALIN E KALIVAÇIT, NDËRMJET ORGANIT SHTETËROR TË AUTORIZUAR, MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, DHE SHOQËRISË KONCESIONARE BEG, SPA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8708, datë 1.12.2000 “Për përjashtime dhe dhënien e disa stimuljeve për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit”, dhe të nenit 35 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit, të formës “BOT” për hidrocentralin e Kalivaçit, ndërmjet organit shtetëror të autorizuar, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe shoqërisë koncesionare BEG, SpA.

2. Pikat 2, 4 e 5 të vendimit nr.222, datë 24.5.1997 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOT”, për HEC-in e Kalivaçit”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha